



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1368 , datë.28. 08. 2010

Për

“Shqyrtimin e ankimeve administrative te Shoqates per Mbrojtjen e Konsumatoreve -ZMK, Shoqata e Operatoreve Alternative, 7 Operatoreve Alternative,¹ Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a, Albtelecom sh.a, ne lidhje me Aktin Administrativ, Vendimi nr.1348, date 26.07.2010 te AKEP, per “Percaktimin e sipermarresit Albtelecom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit te telefonise fikse”

Këshilli Drejtues (KD) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), i përbërë nga:

1. Z. Piro	Xhixho	Kryetar
2. Znj. Alketa	Mukavelati	Anëtar
3. Z. Benon	Paloka	Anëtar
4. Z. Ibsen	Elezi	Anëtar
5. Znj. Zamira	Nurçe	Anëtar

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës 28.08. 2010, sipas procedurës së përcaktuar në ligjin nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, ligjin nr. 8480, datë 27. 05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe Rregullores së Brendshme të AKEP-it, shqyrtoi çështjen me objekt:

- Shqyrtimin e ankimeve administrative te Shoqates per Mbrojtjen e Konsumatoreve -ZMK, Shoqata e Operatoreve Alternative, 7 Operatoreve Alternative², Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a, Albtelcom sh.a, ne lidhje me Aktin Administrativ, Vendim nr. 1348, date 26.07.2010 te AKEP, per “Percaktimin e sipermarresit Albtelecom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit te telefonise fikse”,

¹ “Alban Tirana Nascendo AL” sh.p.k, “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, “Albfrut 2005” sh.p.k, “EJ & BI” sh.p.k, “Voskopë” sh.p.k, “Nisatel” sh.p.k, “FBD” sh.p.k.

² Ankesate Shoqates se Operatoreva Alternative dhe 7 sipermarresve alternative, permbajne ankime edhe ne lidhje me vendimet nr.1345, 1346, dhe 1347, te cilat do te trajtohen nga AKEP me nje vendim te vecante.

BAZA LIGJORE:

1. Germa ç) e nenit 8, neni 31 e vijues, pika 1 e nenit 114 dhe pika 1 e nenit 115 te ligjit nr. 9918, datë 19. 05. 2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*ligji nr. 9918*);
2. Pika 2 e nenit 137, neni 138 e vijues i ligjit nr. 8485, date 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative” (*K.Pr.A*)
3. Pika 17 e nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të ERT-së, nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas pikës 3 të nenit 138 të ligjit nr. 9918
4. “Rregullore per analizen e tregut”, miratuar me Vendim te Keshillit Drejtues nr. 747, date 17.07.2009 (*Rregullorja*).
5. Rregullore per Aksesin dhe Interkoneksionin miratuar me VKD nr. 1300, date 14.06.2010.
6. Vendim i KD nr. 1348, datë 26.07.2010 “Percaktimin e sipermarresit Albtelecom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit te telefonise fikse”

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor, te perbere nga:

- Ankesa e Shoqates per Mbrojtjen e Konsumatoreve-ZMK, ankimimet administrative te AMC sh.a, Vodafone Albania sh.a, Shoqates se Operatoreve Alternative³, dhe ankesat e 7 sipermarresve alternative per anulimin, ndryshimin e pjesshem dhe/ose shfuqizimin/revokimin e Aktit Administrativ Vendimi nr. 1348, date 26.07.2010 te AKEP, “Per percaktimin e sipermarresit Albtelecom sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit”, (*Ankim Administrativ*);
- Vendim nr.1348, date 26.07.2010 te AKEP “Per percaktimin e sipermarresit Albtelecom sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit”; (*Vendimi*);
- Projektvendim i KD te AKEP per “Shqyrtimin e ankimeve administrative te Shoqates per Mbrojtjen e Konsumatoreve -ZMK, Shoqates se Operatoreve Alternative, 7 Operatoreve Alternative, Vodafone Albania sh.a, AMC sh.a, Albtelcom sh.a, ne lidhje me Aktin Administrativ, Vendim nr.1348, date 26.07.2010 te AKEP, per “Percaktimin e sipermarresit Albtelecom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit te telefonise fikse”(Projektvendimi);
- Relacion shpjegues mbi projektvendimin (*Relacioni*);
si dhe,
diskutimeve në mbledhje mbi çështjen, bazës ligjore të sipërcituar,

³ E firmosur nga nga 25 (njetzet e pese) Sipermares Alternative.

V Ë R E N:

1. Shoqata per Mbrojtjen e Konsumatoreve ZMK, me shkresen nr.100824.1 Prot, date 24.08.2010 (AKEP nr.2838/3 prot, date 24.08.2010) ka bere ankese publike ne lidhje me VKD nr.1348, date 26.07.2010, per percaktimin e Albtelcom sh.a me FNT dhe masave rregulluese, duke cituar se AKEP ka vendosur rritjen e tarifave te pajtimtareve per pajtimin mujor, bisedave brenda rrjetit, bisedave lokale dhe nderkombetare dhe jashte rajonit si edhe ka vendosur per rritje drastike tarifave te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit. ZMK kundërshton keto rritje te tarifave duke u shprehur se VKD e AKEP eshte ne kundërshtim te hapur me:
 - a. Dokumentin e Politikave per Komunikimet Elektronike ne Republiken e Shqiperise, ku synohet rritje e konkurrences dhe ulja e cmimeve per konsumatoret;
 - b. VKM nr.854, date 18.06.2008, te Keshillit te Ministrave ne te cilin percaktohet qarte se cfare synimesh ka Qeveria per uljen e tarifave ne telefonine fikse duke ju afruar ndjeshem mesatares se BE;
 - c. Ligjin nr.9918:
 - i. Pika c, neni 8, sipas te cilit tarifat e ofertes reference te operatorit me FNT nuk duhet te jene me te larta se mesatarja e BE;
 - ii. Nenin 110, Keshillimi publik, dhe ligjin nr. 9902, date 17.04.2010, pasi AKEP nuk ka organizuar asnje seance konsultimi publik me palet e interesit;

Shoqata kerkon anulimin e VKD nr.1348, date 26.07.2010, dhe ne rast te mosanullimit shoqata do te ndermarre veprime te reagimit qytetar.
2. Sipermarresit AMC sh.a me shkresen nr. 2724/6 prot, date 25.08.2010, Vodafone Albania sh.a me shkresen nr. 2724/7 prot, date 25.08.2010 Shoqata e Operatoreve Alternative, dhe 7 sipermares Alternative (shiko me siper), brenda afatit ligjor te percaktuar ne nenin 140 te ligjit nr.8485, kane bere ankim administrativ per ndryshimin e pjesshem dhe/ose shfuqizimin/revokimin e Aktit Administrativ Vendimi nr.1348, date 26.07.2010 te AKEP, "Per percaktimin e sipermarresit Albtelcom sh.a, me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit";
3. Shoqata e Operatoreve Alternative me shkresen nr. 2838/1, date 23.08.2010, si dhe 6 sipermarresit e tjere Alternative me shkresat e meposhteme:
 - "Alban Tirana Nascendo AL" sh.p.k me shkresen nr. 2724/4 date 11.08.2010;
 - "Albanian Satellite Communications" sh.p.k me shkresen nr. 2838/2 prot, date 23.08.2010;
 - "Albfrut 2005" sh.p.k me shkresen nr. 2834 prot, date 23.08.2010 "Kerkese ankimore" si dhe shkresa nr. 2836 prot, date 23.08.2010 "Ankese nr.2";
 - "EJ & BI" sh.p.k me shkresen nr. 2838 prot, date 23.08.2010 "Kerkese ankimore";
 - "Voskopje" sh.p.k me shkresen nr. 2835 prot, date 23.08.2010 "Kerkese ankimore" si dhe shkresa nr. 2837 prot, date 23.08.2010 "Ankese nr.2";
 - "NISATEL" sh.p.k me shkresen nr. 2825 prot, date 19.08.2010 "Kerkese ankimore";

- "FBD" sh.p.k me shkresen nr. 2838/4 date 25.08.2010 "Kerkese ankimore",

vleresojne se AKEP nepermjet Vendimit nr. 1348 date 26.07.2010 (**Vendimi**), ka rritur tarifat dhe ky vendim eshte diskriminues per Operatoret Alternative duke demtuar rende aktivitetin e tyre, duke favorizuar Operatoret FNT nepermjet rritjes se cmimeve te sherbimit te interkoneksionit pa u bazuar ne analizen e kosos, metodologjine e rregullimit te tarifave, duke rene ne kundershtrim me vendimin nr.1182, date 10.03.2010 ku tarifa e propozuar nga Albtelecom eshte me e ulet nga tarifa e miratuar prej Keshillit Drejtues te AKEP. OFNT me argumentat e tyre per çmimet e ofruara ne treg tregojne te kunderten e atyre qe pretendohet nga vendimet e AKEP;

4. Palet ankimuese pretendojne se tarifat e reja te Altelecom jane edhe me te larta se para dy vjetesh, per sa me siper kerkojne rishikimin dhe modifikimin perkates te VKD nr. 1348, date 26.07.2010 dhe lenien ne fuqi te tarifave te meparshme te terminimit, origjinimit dhe tranzitimit me Albtelecom sh.a deri ne marrjen e vendimit perkates nga AKEP per studimin e kosos sipas BU-LRAIC per Albtelecom sh.a. Operatoret alternative kerkojne edhe shfuqizimin e pikes 4.5.1/ii per komercializimin e tarifes se thirrjeve hyrese nderkombetare;
5. Albtelecom sh.a me shkresen nr. 3479/2 prot, date 12.08.2010 (AKEP nr. 2724/5 prot, date 13.08.2010) ka bere kerkese per ndreqje gabimi material ne aktin administrativ VKD nr.1348, date 26.07.2010, ku tarifa e thirrjeve lokale drejt rrjeteve te tjere fiks, ne brezin orar te reduktuar, per kategorine Te Tjere, te korrigojohet nga 2.6 lek/minute ne 3.25 lek minute;
6. Ankimet administrative te paleve te interesuara, te cituara me siper, ne lidhje me VKD nr.1348, date 26.07.2010, pezullojne efektet e tij, nga data e depozitimit te ankimimeve ne AKEP deri ne marrjen e nje vendimi perfundimtar te AKEP mbi ankimimet administrative;
7. AKEP, bazuar ne:
 - a. Shqyrtimin e pretendimeve te ankimimeve administrative te paleve te interesuara;
 - b. Percaktimet ne piken 1 te nenit 42 te lligjit nr. 9918;

"AKEP-i vendos ndaj sipërmarrësve me fuqi të ndjeshme në treg detyrimin për të plotësuar kërkesat e arsyeshme për akses dhe interkoneksion, si dhe për përdorimin e elementeve të veçanta të rrjetit dhe faciliteteve shoqëruese, në veçanti, në ato raste kur AKEP-i vlerëson se nga refuzimi i aksesit ose nga kushtet dhe termat e paarsyeshme, pengohet konkurrenca e qëndrueshme në tregun e pakicës, apo kur dëmtohen interesat e përdoruesve fundorë".

- c. Percaktimet ne nenet 45, 57 dhe 59, te lligjit nr. 9918 sipas te cilave, detyrimet per FNT per tarifat duhet te sigurojne qe operatori te marre nje fitim te arsyeshem mbi kapitalin e punesuar dhe duke mbajtur parasysh riskun aktivitetit:

Pika 2 e nenit 45 e lligjit nr. 9918 "Në vendosjen e detyrimeve, sipas pikës 1 të këtij neni, AKEP-i ka në vëmendje edhe investimin e bërë nga sipërmarrësi, lejimin e një norme të arsyeshme fitimi mbi kapitalin e punësuar përfshirë edhe riskun";

Nga te dhena e raportit Cullen International, Albtelecom rezulton me ROCE (norma e fitimit mbi kapitalin e punesuar) shume me te ulet se ne vendet e rajonit, pra me norme fitimi nen nivelin normal: 3.9% eshte shume me ulet se norma e fitimit pa risk ne bonot e thesarit qe aktualisht eshte afersisht 9% dhe se norma e arsyeshme e

fitimit mbi kapitalin e punesuar te percaktuar nga konsulentet nderkombetare per kostot BULRAIC prej 20% .

- d. Rezultatet e kostove BULRAIC te Albtelecom ku vihet re se:
- i. Tarifat aktuale te interkoneksionit (terminim/tranzitim) jane me te uleta se kostot BULRAIC;
 - ii. Tarifa e pajtimit mujor (442 lek/muaj-per tu aplikuar me 1.09) eshte shume me e ulet se tarifa/kostoja per kete sherbim ne nivel me shumice 800 lek/muaj.

Keta dy faktore ndikojne ne nje situate financiare te veshtire per Albtelecom, e cila vihet re edhe nga pasqyrat financiare te Albtelecom sh.a me norma shume te uleta fitimi dhe me te vogla se fitimi normal apo i arsyeshem:

- Pajtimi mujor me i ulet se kosto, krijon ate qe quhet deficit aksesit (access deficit) ne nivel shume te larte (afersisht 1.7 miliard lek/vit);
 - Tarifat e interkoneksionit me te uleta se kosto BULRAIC, jane jo vetem perkeqsuese per Albtelecom sh.a, por edhe zvogelojne stimujt per investime eficente nga operatorët e tjere duke krijuar stimujt per hyrje ineficente, cka eshte vene re edhe ne fokusimin e operatoreve kryesisht per tranzitimin e thirrjeve hyrese nderkombetare pa efekte direkte ne konkurrencen dhe sherbimet e ofruara perdoruesve fundore ne Shqiperi.
- e. Krahasimin e tarifave me pakice dhe me shumice me vendet e rajonit dhe te BE, te pasyruara ne tabelen e meposhteme:

	Pajtimi Mujor (euro/muaj me TVSH)	Thirrje locale 3min (Euro me TVSH)	Thirrje nderkombetare 10 minuta (Euro, me TVSH)	Terminimi thirrje 3 minuta (eurocent/minute, pa TVSH)		
				lokal	Njefish	Dyfish
Shqiperi (VKD 1348)	3.9	0.09	1.36	1.31	2.04	2.78
Kroaci	10.17	0.12	3.82	0.73	1.10	1.78
Maqedoni	7.70	0.06	1.91	0.70	1.03	1.44
Turqi	6.82	0.10	0.58	0.64	0.79	1.24
Mali i Zi	6.89	0.07	1.76	2.25	2.70	
Serbi	2.47	0.02	2.59	1.32	2.07	3.18
Kosove	8.07	0.04	3.71	4.00		
BE mesatare	14.7	0.14	2	0.57	0.86	1.16

Nga tabela vihet re se:

1. Pajtimi mujor eshte shume me i lire se ne ne te gjitha vendet e rajonit dhe BE pervec Serbise;
 2. Thirrjet lokale jane me te lira se ne Kroaci, Turqi, dhe vendet e BE por me te shtrenjta se ne vendet e tjera te rajonit;
 3. Thirrjet nderkombetare jane me te lirat ne rajon dhe vendet e BE, pervec Turqise;
 4. Tarifat e terminimit jane me te larta se ne Kroaci, Maqedoni, Turqi dhe mesatrja e BE, por me te lira se ne malin e Zi, Serbi dhe Kosove;
 5. Tarifat retail jane ndjeshem nen mestaren e BE, ndersa tarifat e terminimit jane me te larta se mesatarja e BE;
 6. Tarifat e terminimit jane me te larta se ne Kroaci, Turqi, Maqedoni dhe mesatarja e vendeve te BE por tarifat retail jane ndjeshem me te lira se ne keto vende;
- f. Rritja e tarifave te interkoneksionit, nuk gjykohet te kete efekte te ndjeshme negative ne konkurrencen ne tregjet me pakice ne Shqiperi, pasi:
- Rritja e tarifave se terminimit shkon nga afersisht 0.8 ne 2 lek/minute dhe keto rritje perbejne nje pjese te vogel te tarifave qe abonentet e ketyre rrjeteve alternative paguajne per thirrjet drejt Albtelecom, qe kryesisht jane ne nivele me te larta se 1.5 lek/minute per thirrje lokale, duke arritur kryesisht ne vlera si 12 lek/minute per thirrje kombetare drejt Albtelecom (madje edhe 20 lek/minute). Konkurrenca me e madhe eshte per sherbime te reja si Internet, dhe OA kryesisht jane te perqendruar ne tranzitimin e thirrjeve hyrese nderkombetare pa efekte direkte tek abonentet dhe tregjet me pakice ne Shqiperi.
 - OA do te perfitojne tarifa me te larta terminimi ne rrjetet e tyre (zakonisht palet kane rene dakort per asimetri prej 30% mbi Albtelecom), dhe kjo lejon kushte jo-diskriminuese per konkurrencen midis operatoreve te rrjeteve fikse;
 - Tarifat e operatoreve celulare drejt Albtelecom dhe OA, jane ne nivele rreth 20 lek/minute dhe tarifa e terminimit ne Albtelecom prej 3.5 lek/minute eshte pjese shume e vogel e tarifave qe perdoruesit celulare paguajne. Rritja e tarifave se terminimit ne nivelin e percaktuar mund te ndikojne ne marzhin e fitimit te operatoreve celulare, por kjo gjithsesi eshte shume e larte aktualisht (ROCE e operatoreve celulare eshte ne nivel 30-40% krahasuar me nivelin e arsyeshem prej 20% te percaktuar nga modeli BULRAIC).
 - Rritja e tarifave eshte e perkoheshme dhe sic eshte theksuar ne Analizen e tregut, AKEP do te kryejne konsultime publike dhe marre vendime ne periudhen Shtator-Dhjetor 2010, per ribalancimine tarifave me pakice te Albtelecom dhe orientimin ne kostot BULRAIC te tarifave me shumice te interkoneksionit te Albtelecom.

Gjykon se:

- Arsyetimi i perdorur ne analizen e tregut te telefonise fikse, pjese e VKD nr. 1348, date 26.07.2010, eshte i drejte;
- Ne menyre qe te aplikohen tarifat e kostove BULRAIC, eshte e domosdoshme ribalancimi i plote i tarifave te Albtelecom (d.m.th pajtimi mujor per

konsumatorët e kategorise familjare të arrijë në nivele 1000 lek/muaj), dhe për sa kohë nuk ka përfunduar ky proces, tarifimi i interkoneksionit në nivel BULRAIC do të kishte efekte tepër negative (me të mëdha kur është nën kosto BULRAIC) për Albtelecom dhe tregun në interes;

- Aplikimi më 1.09.2010 i tarifave aktuale të interkoneksionit të Albtelecom do të bente të nevojshme që në të njëjtën kohë tarifa e pajtimit mujor të Albtelecom të rritet në mënyrë të menjehershme mbi 1000 lek në muaj, çka do të ishte me pasoja të rënda për konsumatorët dhe kundër objektivave të ligjit nr. 9918 dhe ligjit nr. 9902, për mbrojtjen e interesave të konsumatorëve;
 - Me qëllim lehtësimin e peshës së rritjes së pajtimit mujor për pajtimtarët Familjare, rritja e tarifës së thirrjeve lokale të vendosur në VKD nr.1348, datë 26.07.2010, të anulohet dhe Albtelecom të kompensohet pjesërisht me rritje të tarifës së thirrjeve për pajtimtarët kategorise të tjera.
8. Në lidhje me pretendimet se AKEP nuk ka kryer konsultim me palet e interesuara, sqarojmë se në bazë të parashikimeve të nenit 35, të Ligjit nr. 9918, dokumenti "Analizë e Tregut të Telefonisë Fikse: Tregjet me pakice të aksesit dhe thirrjeve telefonike nga vendndodhje fikse dhe tregjet me shumicë të terminimit, origjinimit dhe tranzitimit në rrjetë fikse: Konsultim Publik" (në vijim referuar Analiza 2009-konsultim publik) i miratuar me VKD të AKEP nr. 975, datë 17.09.2009, u publikua në faqen e Internetit të AKEP për keshillim publik me palet e interesuara dhe procesi i konsultimit u krye për statusin e FNT dhe për detyrimet e propozuar për FNT. Periudha e konsultimit publik përfundoi më 20.11.2009. Në përfundim të procesit të keshillimit publik, në adresë të AKEP, kanë ardhur komente nga Autoriteti i Konkurrencës dhe operatori Davis Com, komentet dhe përgjigjet e të cilave janë reflektuar në dokumentin përfundimtar të Analizës së tregut. Gjithashtu, AKEP ka kryer dy konsultime publike në lidhje me koston BULRAIC të Albtelecom, dhe dokumentat janë publikuar në faqen e Internetit të AKEP, por në adresë të AKEP nuk ka ardhur asnjë koment nga palet e interesuara.
9. Në lidhje me pretendimet se dokumenti i Analizës finale të tregut, të miratuar me VKD nr.1348, datë 26.07.2010, nuk është publikuar nga AKEP, sqarojmë se ky dokument mund të gjendet në linkun: <http://www.akep.al/sq/konsultime/konsultime-te-perfundura>.
10. Në dokumentin përfundimtar të Analizës së tregut të telefonisë fikse, AKEP ka sqaruar midis të tjerave se:

AKEP synon të përshejtojë dhe përfundojë plotësisht procesin e ribalancimit të tarifave të Albtelecom në dy faza, duke lejuar përkohejishtë tarifën interkoneksioni me të larta se niveli aktualë dhe niveli i kostove BULRAIC.

Keto vlera do të jetë në fuqi deri në një vendim tjetër të AKEP (shiko më poshtë).

Në përfundim të një procesi konsultimi publik në muajt Shtator-Nëntor 2010, AKEP do të përcaktojë procedurat e rregullimi të tarifave të Albtelecom⁴ në mënyrë që brenda vitit 2011 të përfundojë ribalancimin i plotë të tarifave të pajtimtarëve, e cila do të synojë lejimin e Albtelecom të rrisë tarifën e pajtimit mujor nga 442 në 1000 lek/muaj dhe imponimin e reduktimit të metejshëm të tarifave të thirrjeve të pajtimtarëve Familjare dhe Biznes dhe të interkoneksionit. Në këtë proces ribalancimi i plotë, që përfshin rritjen e ndjeshme të tarifës së pajtimit mujor për Familjarët, AKEP do të bashkëpunojë me Albtelecom për të gjetur masa lehtësuese për konsumatorët e vegjël, tek të cilët efekti negativ do të jetë më i ndjeshëm, siç janë rastet e paketave të vecnata apo përfshirja e minutazhit falas në pajtim mujor. Në këtë proces do të përdoren gjerësisht të rezultatet e modelit BULRAIC të kostove të Albtelecom.

⁴ Tarifat me shumicë dhe me pakice

Procesi i ribalancimit te tarifave te Albtelecom, megjthese mund te kete efekte negative ne nje grup perdoruesish te vegjel (qe konsumojne kryesisht vetem thirrje lokale), eshte nje proces i nevojshem per te eliminuar problemet historike ne tarifimin jo-te orientuar ne kosto dhe ka efekte pozitive ne perdoruesit e tjere, konkurrencen ne treg dhe ne rritjen e stimujve te Albtelecom per te investuar ne linja te reja telefonike per abonentet, per te cilen Shqiperia ka shume nevojte dhe qe do sherbejne edhe per rritjen e metejshme te perdorimit te Internetit (Shqiperia ka nivelin me te ulet ne Rajon dhe Europe te penetrimit te linjave te telefonise fikse dhe Internet Broadband).

Ky proces do te lejoje eliminimin/reduktimin e problemeve aktuale ne tregun e telefonise fikse dhe implementimin e masave rregullatore te nevojshme qe synoje:

- 1. Rritjen e konkurrences nepermjet implementimit te masave rregullatore si C(PS), LLU dhe stimulimin e investimeve ne infrastrukture te linjave fikse (telefoni/Internet broadband);*
 - 2. Rritjen e stimujve per investime nga Albtelcom nepermjet permiresimit te situates financiare te Albtelecom (per te realizuar fitim normal nga sherbimet nen-rregullim)dhe*
 - 3. Rritjen e perfitimeve te perdorusve/konsumatoreve nga sherbimet e telefonise fikse dhe aksesit ne Internet, nepermjet rritjes se numrit te perdorusve, reduktimi i tarifave te perdorimit dhe rritjen e cilesise se sherbimeve.*
11. Ne lidhje me pretendimet e operatoreve alternative per terminimin e trafikut nderkombetar, AKEP ka bere sqarimet dhe arsyetimin ne vendimet nr.1345, nr.1346 dhe nr.1347, date 23.07.2010;
 12. Ne lidhje me kerkesen e Albtelecom per korrigjim te tarifes se thirrjeve lokale drejt rrjeteve te tjere fikse, ne brezin orar te reduktuar, per kategorine Te Tjere, AKEP gjykon se kerkesa eshte drejte pasi gabimisht eshte vendosur velra 2.6 ne vend te 3.25.

P Ë R K Ë T O A R S Y E :

Bazuar ne piken 1 te nenit 114 dhe piken 1 te nenit 115, te ligjit nr. 9918, nenin 135 e vijues te K.Pr.A, si dhe piken 17 te nenit 21 te Rregullores se Brendshme,

V E N D O S :

1. Te pranoje pjeserisht ankesen e Shoqates se Mbrojtjes se Konsumatoreve ZMK, ne lidhje me rritjen e tarifave te thirrjeve lokale per pajtimatret Familjare (konsumatorët), duke anuluar rritjen e ketyre tarifave, sipas percaktimeve te pikes 3 me poshte;
2. Te pranoje kerkesen e Albtelecom per korrigjimin e tarifes se thirrjeve lokale drejt rrjeteve te tjere fikse, ne brezin orar te reduktuar, per kategorine Te Tjere;
3. Ne VKD nr.1348 date 26.07.2010 per "Percaktimin e sipermarresit Albtelecom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit te telefonise fikse", ne piken 4.5.2/i, tarifat e theksuara ne tabelen e meposhteme,

Sherbimi	Njesia	Kategoria e Pajtimtarit/Paketa tarifore	
		Familjare	Te Tjere
Pajtimi Mujor	Lek/muaj	442	1500
Biseda Telefonike LOKALE brenda rrjetit Albtelecom			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	3.00	3.90
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	2.50	3.25
Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve te tjere fiks			
Lokale			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	3.00	3.90
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	2..50	2.60
Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve celulare			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	26.09	35.45
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	20.00	26.00

te ndryshohen sipas tarifave ne tabelen ne vijim:

Sherbimi	Njesia	Kategoria e Pajtimtarit/Paketa tarifore	
		Familjare	Te Tjere
Pajtimi Mujor	Lek/muaj	442	1600
Biseda Telefonike LOKALE brenda rrjetit Albtelecom			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	2.50	3.90
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	1.60	3.25
Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve te tjere fiks			
Lokale			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	3.00	3.90
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	2.50	3.25
Biseda Telefonike KOMBETARE drejt rrjeteve celulare			
Brezi Orar i ZAKONSHEM	Lek/min	26.09	45.00
Brezi Orar i REDUKTUAR	Lek/min	20.00	35.00

4. Te mos pranoje kerkesat e Shoqates se Mbrojtjes se Konsumatoreve-ZMK, Shoqates se Operatoreve Alternative, 7 sipermarresve alternative,⁵ AMC dhe Vodafone Albania per anullimin dhe/ose ndryshimin e tarifave te interkoneksionit te percaktuara ne vendimin nr.1348, date 26.07.2010 dhe percaktimeve te tjera te ketij vendimi.
5. Te gjitha percaktimet e tjera te Vendimit nr.1348 date 26.07.2010 per “Percaktimin e sipermarresit Albtelcom Sh.a., me Fuqi te Ndjeshme ne Treg dhe vendosjen e masave rregulluese ne tregjet me pakice te telefonise fikse dhe tregjet me shumice te interkoneksionit te telefonise fikse”, ngelen te pandryshuara dhe ne fuqi.
6. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit te AKEP: www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi në datën e miratimit të tij.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARET E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alketa MUKAVELATI**
2. **Benon PALOKA**
3. **Ibsen ELEZI**
4. **Zamira NURCE**

⁵ “Alban Tirana Nascendo AL” sh.p.k, “Albanian Satellite Communications” sh.p.k, “Albfrut 2005” sh.p.k, “EJ & BI” sh.p.k, “Voskopë” sh.p.k, “Nisatel” sh.p.k, “FBD” sh.p.k.